

VENDIM
Nr. 32/2016

**PËR MIRATIMIN E PËRBËRJES SË KOMISIONIT HETIMOR TË KUVENDIT PËR TË HETUAR DHE VERIFIKUAR ZBATIMIN E LEGJSLACIONIT NË FUQI DHE MBROJTJEN E INTERESIT TË SHETIT SHQIPTAR GJATË PROCEDURAVE TË PRIVATIZIMIT TË OPERATORIT TË SISTEMIT TË SHPËRNDARJES DHE NEGOCIMI I MARRËVESHJES SË SHITJES SË AKSIONEVE, MIRATUAR ME LIGJIN NR. 10116, DATË 23.4.2009, “PËR MIRATIMIN E KONTRATËS SË SHITJES SË 76 PËR QIND TË AKSIONEVE TË OPERATORIT TË SISTEMIT TË SHPËRNDARJES (OSSH) SHA-SË NDËRMJET MINISTRISË SË EKONOMISË, TREGTISË DHE ENERGJETIKËS SË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE CEZ AS”, SI EDHE EVIDENTIMI I EFEKTEVE NEGATIVE FINANCIARE TË SHKAKTUARA NGA NDJEKJA E ZBATIMIT TË KËSAJ MARRËVESHJEJE”,
NGRITUR ME VENDIMIN E KUVENDIT NR. 30/2016**

Në mbështetje të nenit 78, pika 1, të Kushtetutës, nenit 55, pika 1, të Rregullores së Kuvendit dhe të nenit 9, të ligjit nr. 8891, datë 2.5.2002, “Për organizimin dhe funksionimin e komisioneve hetimore të Kuvendit”, me propozimin e Kryetarit të Grupit Parlamentar të Partisë Socialiste dhe Kryetarit të Grupit Parlamentar të Partisë Demokratike,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

I. Miratohet përbërja e komisionit hetimor për të hetuar dhe verifikuar zbatimin e legjislacionit në fuqi dhe mbrojtjen e interesit të shtetit shqiptar gjatë procedurave të privatizimit të Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes dhe negocimi i Marrëveshjes së Shitjes së Aksioneve, miratuar me ligjin nr. 10 116, datë 23.4.2009, “Për miratimin e kontratës së shitjes së 76 për qind të aksioneve të Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes (OSSH) sh.a. ndërmjet Ministrisë së Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës së Republikës së Shqipërisë dhe CEZ a.s.”, si edhe evidentimi i efekteve negative financiare të shkaktuara nga ndjekja e zbatimit të kësaj marrëveshjeje, ngritur me vendimin e Kuvendit nr. 30/2016, si më poshtë:

- | | |
|---------------------|----------------------|
| 1. Taulant Balla | Kryetar (PS) |
| 2. Sherefedin Shehu | zëvendëskryetar (PD) |
| 3. Ulsi Manja | anëtar (PS) |
| 4. Pjerin Ndreu | anëtar (PS) |
| 5. Evis Kushi | anëtare (PS) |
| 6. Ervin Koçi | anëtar (PS) |
| 7. Bujar Derveni | anëtar (PDIU) |
| 8. Ridvan Bode | anëtar (PD) |
| 9. Gjergji Papa | anëtar (PD) |
| 10.Arben Ristani | anëtar (PD) |
| 11. Liljana Elmazi | anëtare (PD) |
- II. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Miratuar në datën 21.4.2016

KRYETARI
Ilir Meta

